



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Nr. _____ Prot.

Tiranë më ____. ____. _____

Proces-verbal

**Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile
Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile**

I mbajtur sot më datë 24.02.2017 në orën 12:00 në ambientet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Të pranishëm konfirmohen anëtarët si më poshtë - përfaqësues të Shoqërisë Civile pranë Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile:

1. Znj. Iris Luarasi;
2. Z. Blendi Dibra;
3. Z. Ali Coka;
4. Z. Ilir Papaproko
5. Znj. Erisa Lame;
6. Z. Luan Ahmetaj;
7. Z. Ergys Gezka;
8. Z. Vladimir Thanu;
9. Znj. Zana Vokopola;
10. Z. Altin Hazizaj;

Përfaqësues të zyrave të OSBE-së janë:

1. Znj. Sihana Nebiu;
2. Z. Elton Lelo;

Nga ana e Sekretariatit Teknik, të pranishëm janë:

1. Z. Andi Kananaj - Drejtor Ekzekutiv;
2. Znj. Mikela Kakeli;
3. Znj. Yllka Demollari;
4. Z. Ferhat Aga;

Fjalën e hapjes e mori Drejtori Ekzekutiv i AMShC- së i cili theksoi frymën e bashkëpunimit mes organeve të qeverisjes qendrore dhe shoqërisë civile. Drejtori Ekzekutiv, propozoi gjithashtu ndarjen në grupe të përfaqësuesve të shoqërisë civile në Këshill në mënyrë që të realizohen dhe zgjidhen probleme që kërkohen nga Ligji.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Diskutimet nga të pranishmit u vijuan edhe më tej lidhur me përcaktimet ligjore dhe orientimet e natyrës së organizimit të mbledhjeve; zgjedhjen e zëvendëskryetarit por edhe kriteret që do të duhet të plotësohen me këtë rast.

Në mbledhje gjithashtu u diskutua edhe mbi mënyrën e hedhjes së shortit ku u ra dakord sipas mënyrës së ndarjes së emrave të kandidatëve dhe mandateve përkatëse në 2 (dy) kutia të veçanta dhe tërheqjen prej tyre të një emri dhe numri i cili do të identifikonte edhe mandatin përkatës.

Mbledhja e radhës u vendos unanimisht të caktohet për në ditën e mërkurë, datë 1 Mars 2017 ora 10:00 në të cilën do të realizohet hedhja e shortit dhe finalizimi i rregullores së bashku me të gjitha amendimet të përfunduara deri ditën e Hënë datë 27 Shkurt 2017.

Mbledhja u mbyll në orën 13:45.